



NJOFTIM

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, shpall konkursin për 11 vende të reja pune për personel akademik me kohë të pjesëshme (Part-Time) në Filialin e Peshkopisë, sipas departamenteve dhe specialiteteve të mëposhtme. Qendra e punës do të jetë në qytetin e Peshkopisë.

1. Departamenti i Shkencave të Aplikuara ;

1.1	<u>Specialiteti:</u>	a- Informatikë	4 vende
		b- Matematikë	2 vende
		c- Fizikë	2 vende
		d- Mjekësi	2 vende
		e- Kimi	1 vend

A. Të interesuarit për vendet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në specialitetin e kërkuar. Preferohen personat që kanë mbaruar: Diplomë të Nivelit të Dytë, Master Shkencor dhe/ose Doktor në specialitetin përkatës.
2. Të jetë i aftë të garantojë vlerësimin, efikasitetin dhe ekselencën e lëndëve që do të japë.
3. Të ketë njohuri mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
4. Të njohë dhe të jetë familjar me sistemin e funksionimit të universiteteve perëndimore dhe të Kartës së Bolonjës.

B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e aplikimit për personel akademik i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të universitetit në adresën www.uamd.edu.al, ose të tërhiqet dorazi në zyrën e Degës së Burimeve Njerëzore të universitetit;
2. Tre letra rekomandimi nga pedagogë apo udhëheqës shkencor të kandidatit dhe të paktën një nga tre letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
3. Fotokopje të diplomës, të noterizuar;
4. Fotokopje të çertifikatës së notave të noterizuar;
5. Fotokopje të dëshmimeve kualifikimi të ndryshme, të noterizuara;
6. Fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale / shkencore dhe / ose punime të tjera;
7. Fotokopje të pasaportës ose të një dokumenti identifikimi;

8. Të përgatisin një orë të hapur leksioni lidhur me specialitetin për të cilin aplikojnë;
9. Deklaratë nga kandidati aplikues për gjëndjen gjyqësore.

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, duhet të jenë të përkthyer dhe të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38.

- C. **Afati i fundit i pritjes aplikimeve është deri në 30.11.2010. Do të shqyrtohen vetëm paketat e aplikimit që përmbushin kriteret e sipërpërmendura.**
- D. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën;
Universiteti “Aleksandër Mosiu”
Për Filialin e Peshkopisë
Departamenti: _____
Specialiteti: _____
Lagja 1, Rruga e Currilave, Durrës.
- E. *Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.*
- F. *Procedura e përzgjedhjes së kandidaturave fillon menjëherë pas publikimit të këtij njoftimi dhe do të zhvillohet sipas Udhëzimit Nr. 129, datë 30.01.2009 “Për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit akademik, ndihmës mësimesor – shkencor dhe administrativ, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.*